



Data: 18.05.2018

Ref.: 440/18D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 55-të, të mbajtur më 10 Maj 2018, mori:

## V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Kolegjit "AUK" për ofrimin e koncenttimeve profesionale dhe koncenttimeve minore shtesë brenda programit të studimit: Baçelor i Shkencës në Arte dhe Shkencat Aplikuara, sipas vendimit nr.725/14, datë: 28.08.2014, të KSHC-së të validuar nga Rochester Institute of Technology (RIT).

## Arsyetimi

Kolegji "AUK", ka parashutuar kërkesë me nr.827/17, datë:15.12.2017, në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), për ofrimin e koncenttimeve profesionale dhe koncenttimeve minore shtesë brenda programit të studimit: Baçelor i Shkencës në Arte dhe Shkencat Aplikuara, sipas validimit nga Rochester Institute of Technology (RIT).

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe kontrollimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji "AUK" përfshirë dokumentit të valdimit të lëshuar nga Rochester Institute of Technology (RIT), u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "AUK"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

